

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN LIBOFSHË, FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Libofshë, Fier, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë së komunës etj”. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 174, datë 30.12.2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 989/6, datë 30.12.2012, dërguar z. **Naum DOKO**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Nga ana e Zyrës së Taksave , bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “ Për Procedurat tatimore”, të nxirret njoftim vlerësimit për 26 subjekte për vlerën **223,755 lekë**, si më poshtë:

a) për 22 subjektet të cilat nuk janë regjistruar në QKR, për vlerën 203,755 lekë. b) për 4 subjekte të cilëve si rezultat i rivlerësimit të xhiros, u është rritur detyrimi tatimor në vlerën 20,000 lekë, përkatësisht: [REDAKTUAR] në vlerën 4,000 lekë; [REDAKTUAR] në vlerën 4,500 lekë; [REDAKTUAR] në vlerën 5,000 lekë dhe [REDAKTUAR] në vlerën 6,500 lekë.

Menjëherë

2. Për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, rekomandojmë të merren masa që:

-të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të Komunës Libofshë, me qëllim që të mundësojë detyra të qarta dhe rregulla edhe për funksionimin e aktivitetit të ujësjellësve të fshatrave.
-të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si; data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj. sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë

3. Nga Komuna Libofshë, bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të merren masa dhe të ngrihen grupe pune për rakordimin dhe saktësimin e taksës së tokës, pasi më datën 30.12.2011 rezultojnë debitorë 1,732 familje në vlerën 12,775,000 lekë. Duke i grupuar sipas fshatrave, viteve dhe personave, sa nuk paguajnë dhe arsyet e mos pagesës. Të shikohet mundësia e informatizimit dhe hedhjes graduale në sistem elektronik, të debitorëve për taksën e tokës dhe banesave

Menjëherë

4. Nga ana e Zyrës së Financës të hapen: Libër i Madh apo Centralizator dhe analizat (partitarë) për llogaritë: 468- Debitorë të ndryshëm; Ilogarinë 401-408- Furnitorë e Ilogari të lidhur me to dhe llogaria 467- Kreditorë të ndryshëm. Sipas kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I - Mbajtja e kontabilitetit,

pika 2 shkronja c-Dokumentet e kontabilitetit, pika 2.3- Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit.

Menjëherë

5. Nga ana e Komunës Libofshë të kryhet një studim për riorganizimin e aktivitetit të Ujësjetësve me qëllim që të sigurohet rentabiliteti i shërbimit, duke e shoqëruar edhe me masat e mëposhtme;

-lidhjen e kontratave me konsumatorët familjarë dhe jo familjar për njohjen e detyrimeve përkatëse duke aplikuar edhe penalitete (kamat vonesa).

-prodhimin e faturave të ujit të pijshëm me numër serie duke u miratuar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe të regjistrohen në kontabilitet, si për sasinë e ujit të shitur dhe vlerën e paguar, duke nxjerrë debitorë personat të cilët nuk paguajnë.

- faturat e ujit të pijshëm të hartohen nga një person tjetër i cili nuk duhet të ketë lidhje edhe me grumbullimin e lekëve.

- të caktohet një inspektor i ujit të pijshëm.

-për saktësimin e harxhimit të energjisë elektrike në ujësjetësit, të lidhen kontrata me ÇEZ-Shpërndarjen, duke vendosur matës dhe rakorduar në vazhdimësi për sasinë e energjisë elektrike të harxhuar

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Komunës

B . MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nga Komuna Libofshë, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **574,756 lekë**, si më poshtë:

1. Vlera 317,470 lekë, e cila përfaqëson mos pagesën e faturave të ujit të pijshëm nga 423 abonentë për periudhën e vitit 2011- 6/Mujori parë 2012.

Menjëherë

2. Vlera 195,146 lekë, e cila përfaqëson tejkalimin e limitit mujor të përcaktuar për telefoninë celulare, përkatësisht nga [REDAKTUAR], ish-Kryetari i Komunës në vlerën 131,551 lekë, nga të cilat për vitin 2010 - 90,373 lekë dhe 5 mujorin 2011-41,178 lekë dhe nga [REDAKTUAR], Kryetari aktual i Komunës në vlerën 63,595 lekë, nga e cila, për periudhën Shtator-Dhjetor 2011-13,730 lekë dhe periudhën Janar-Qershor 2012, për 49,865 lekë. Pagesa këto në kundërshtim me VKM nr. 343, datë 11.7.2002 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik, publike”, shfuqizuar me VKM. nr. 864, datë 23.7.2010.

Menjëherë

3. Vlera 37,500 lekë, nga [REDAKTUAR], ish-Drejtoresh e Financës, për sa ka paguar me urdhër shpenzimit nr. 129, datë 19.8.2010, për subjektin privat [REDAKTUAR] shpenzime për pritje përcjellje, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995 ndryshuar me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 “Për shpenzimet për pritje përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”

Menjëherë

4. Vlera 24,640 lekë, nga [REDAKTUAR], ish-Përgjegjës i Shërbimeve, pasi është paguar në muajin Gusht të vitit 2010, për leje të zakonshme të pakryer në vitin 2009. Në kundërshtim me VKM nr. 591, datë 23.7.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” i dalë për kufizimin e shpenzimeve të vitit 2010.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kontratën individuale të punës neni 12, shkronja (b), bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Libofshë, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit si më poshtë:

a. "Vërejtje me paralajmërim", bazuar në Kontratën individuale të punës shkronja (b), për 8 punonjësit si më poshtë:

1. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Përgjegjëse e zyrës së financës për vitin 2010, aktualisht inspektore e pagave dhe financës.

2. [REDAKTUAR], me detyrë, arkëtare dhe llogaritare e Ujësllësimit për vitin 2010 e para dhe në vazhdim.

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk kanë hapur dhe azhurnuar, rast pas rasti analiza (partitarët) për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, por ato janë mbajtur në total në zërin e të ardhurave.

-nuk janë në gjendje të nxjerrin debitorët e ujit të pijshëm për vitin 2010 dhe më përpara.

-nuk kanë kryer asnjëherë kontroll për administrimin e të ardhurave nga uji i pijshëm, duke shkelur nenin 44 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1994 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".

-nuk kanë kryer inventarizimin fizik të faturave të ujit të pijshëm në lidhje me vlerën e ujit të shitur dhe arkëtuar, në kundërshtim me nenin 7-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

-kanë lejuar që hartimi i faturave të ujit të pijshëm dhe grumbullimi me lekë në dorë nga qytetarët është kryer nga i njëjti person dhe nuk kanë bërë rakordimin për personat e larguar dhe kanë qene të caktuar me grumbullimin e lekëve, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare".

-kanë lejuar që blloqet e faturimit të ujit të pijshëm të mos mbaheshin dhe administroheshin si letra me vlerë, në arkë ose magazinë. Veprime këto në kundërshtim me nenin 43 të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare".

-nuk kanë zbatuar VKM nr. 236, datë 10.05.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjare", ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.02.2007 dhe udhëzimi nr. 03, datë 28.07.2004 të ish-Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për administrimin e ujit të pijshëm".

-nga mungesa e kontrollit rezulton se për periudhën e vitit 2011- 6/Mujori parë 2012 konsumatorët nuk kanë paguar detyrimet e ujit të pijshëm në vlerën 317,470 lekë, sipas listave në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. [REDAKTUAR], me detyrë ish-Përgjegjës i zyrës së taksave, për 8 muaj, nga data 15.7.2011 deri 01.3.2012, aktualisht specialist veteriner në Komunë.

4. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-inspektorit të Biznesit për 8 muaj nga data 12.7.2011 deri 01.3.2012, mbas kësaj date për periudhën 3 mujore me detyrën e Përgjegjës të Zyrës së taksave, nga data 01.3.2012 deri 30.06.2012 e në vazhdim.

5. [REDAKTUAR], me detyrë Inspektor i taksës së tokës, për 8 muaj nga data 15.7.2011 deri 01.3.2012.

Për shkeljet e mëposhtme;

-nuk kanë ushtruar kontrolle për mbajtjen e saktë të librave, mbajtjen e xhiros, striçot e kasës fiskale, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” .

- ndaj subjekteve të cilët nuk i kanë paguar detyrimet tatimore në afat, nuk kanë bërë llogaritje e kamat vonesave në masën 5 për qind në muaj por jo më tepër se në masën 25 për qind, në kundërshtim me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

-ndjekja e taksës së tokës nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi këtë taksë e paguajnë vetëm 10 për qind e fermerëve dhe për pasojë më datën 30.06.2012 mbeten debitorë 1,732 familje me vlerën 12,775,000 lekë.

6. ████████, Inxhinier Topograf, ish-inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor i Komunës Libofsh, për periudhën 7 mujore, nga data 15.7.2011 deri më datën 10.02.2012 dhe pas kësaj date Përgjegjësi i Zyrës së urbanistikës.

Për shkeljet e mëposhtme;

-për periudhën e audituar Korrik 2011- Shkurt 2012 , nuk ka vendosur asnjë gjobë apo të ketë ndërhyrë me vendime për prishje të ndërtimeve të kundërligjshme apo për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës. Veprime këto në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit” i ndryshuar.

7. ████████, me detyrë punonjës policie për gjithë periudhën e auditimit 2010-2011 dhe -6/mujori i parë 2012.

8. ████████, me detyrë punonjës policie për periudhën një vjeçare Korrik 2011-Korrik 2012.

Për shkeljet ligjore të mëposhtme;

-edhe pse 22 subjekte nuk janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit shkurt (QKR), 10 prej tyre aktivitet të mirëfilltë tregtie (Bar- Kafe), të cilët që nga viti 2010 ushtrojnë aktivitetin pa u licencuar dhe nuk paguajnë taksat vendore, duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Komunës për shumën 203,755 lekë. Ndërkohë atyre nuk u është mbyllur veprimtaria dhe nuk u janë u konfiskuar materialet siç, përcaktohet në pikën 1 të nenit 41, të ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, ndryshuar me ligjin nr. 10,415, datë 07.04.2011.

-për mos regjistrimin e subjekteve të mësipërme, nuk janë vendosur gjoba, duke mos zbatuar edhe Vendimin e Këshillit të Komunës Libofshë, nr. 1, datë 21.01.2010 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore”, sanksione të cilat janë përsëritur edhe me vendimin nr. 37, datë 30.11.2010 dhe nr. 109, datë 13.12.2011.

-për mos nisjen e procedurave të nevojshme ligjore në lidhje me arkëtimin e 4 gjobave të vendosura në harkun kohor 2010-30.06.2012, në vlerën 20,000 lekë. Veprim në kundërshtim me nenet 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” .

-për mos nisjen e procedurave të nevojshme ligjore në lidhje me arkëtimin e 14 gjobave të vendosura në harkun kohor viti 2004 -2009, në vlerën 35,000 lekë, në kundërshtim me nenet 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” .

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Niko Nako, Muhamet Kavaja dhe përparim Gjuzi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Albert Thoma, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT